



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË
Dhoma Penale

Nr.2315/105S.P/1021Regj.Themeltar

Nr.444

Vendimi

Dt.Regj.S.P./20.09.2021/23.02.2022 Regj.Them.

Dt. 23.02.2022

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
Gjyqtar Altin Abdiu

asistuar nga sekretare gjyqësore **Besarda Allaraj**, date 23.02.2022, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore çështjen penale që u përket;

Prokuroria Prane Gjykates Se Rrethit Gjyqësor Tirane, me prokuror Dritan Nushi me autorizim ne vend te prokurorit Adriano Dyrmishi.

I pandehur: **Saimir Sulaj**, i biri i Ahmet dhe Asije, dtl. 20.09.1963, lindur dhe banues ne Tirane, rruga “Sikrat Miho”, pallatet “Fratari”, shk. 3, ap. 24, me shtetesi e kombesi shqiptar, arsim te mesem, i martuar, i denuar, me masen e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqësore”, identifikuar me karte ID me nr. personal G 30920064 D, mbrojtur nga avokate e caktuar kryesisht av. Klementina Caushaj, Dhoma e Avokatise Tirane.

Akuzuar:Per kryerjen e vepres penale “Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike”, parashikuar nga neni 244 pg. 1 i Kodit Penal.

Objekti:Dergimin e çështjes ne gjyq.

Baza Ligjore:Neni 331 Kodi Procedures Penale.

Ne konkluzionet perfundimtare prokurori kerkoi:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit Saimir Sulaj per kryerjen e vepres penale “Korrupsion aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike” parashikuar nga neni 244 i K.Penal, denimin e tij me 6(gjashte) muaj burgim.
- Aplikimin e kerkesave te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 dhe denimin me 4(kater) muaj burgim.
- Zbatimin e nenit 59 te K.Penal, duke pezulluar denimin me burgim dhe duke e vene ne prove te pandehurin për një afat 8(tete) mujor.

- Shpenzimet proceduriale ti ngarkohen te pandehurit.

-Avokatja dhe i pandehuri paraqiten kerkesen per zhvillimin e gjykimit te shkurtuar dhe ne konkluzionet perfundimtare kerkuan nje denim sa me te bute, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim, aplikimin e nenit 59 te Kodit Penal.

-I pandehuri deklaroi se eshte dakord te kryeje nje pune ne interes publik dhe perfundimisht i kerkoi Gjykates meshire.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN

Prokuroria Pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane, ka paraqitur kerkesen per dergimin ne gjyq te çështjes penale ndaj te pandehurit Saimir Sulaj, i akuzuar per kryerjen e veprës penale “Korrupsion aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike”, parashikuar nga neni 244 pg. 1 i K.Penal.

Nga shqyrtimi gjyqesor i çështjes, e cila eshte ne juridiksionin dhe kompetencen e kesaj Gjykate, ka rezultuar se:

Ne daten 12.07.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, mbi bazen e materialeve te ardhura nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane, ka rregjistruar procedimin penal Nr.5028, per vepren penale "Korrupsion aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike" të parashikuar nga neni 244/1 te K.Penal ne ngarkim te shtetasit Saimir Sulaj.

Më datë 11.07.2021 në orën 10:30, eshte kryer njoftimi nga salla operative e Drejtorisë Vendore e Policisë Tiranë, se punonjesit të qarkullimit rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë kishin kapur në flagrance shtetasin Saimir Ahmet Sulaj, i datëlindjes 20.09.1963, për kryerjen e veprës penale "Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 244 i K.Penal.

Ne datë 11.07.2021, shtetasi Edison Bajraktari me detyrë punonjës i qarkullimit rrugor pranë komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, në Seksionin e Trafikut Urban ka qenë i planizuar trup shërbimi autopratullë turni i parë (ora 06:00-14:00) me kod shërbimi 82/16 bashkë me kolegun e tij Eljon Hoxha ku ishin të vendosur për shkeljet prezente në rrugën "Teodor Keko" pranë ish karburant Kastrati drejt pallatit me shigjeta. Drejtuesi i mjetit me targë AA876MV po vinte nga rrethi i Kastratit drejt pallatit me shigjeta dhe kanë konstatuar që qarkullonte me mjet pa vendosur rripin e sigurimit. I bëri shenjë ndalimi duke e pozicionuar në anë të rrugës dhe i është afruar duke i komunikuar shkakun e ndalimit që qarkullon pa vendosur rripin e sigurimit. Në këtë moment i ka kërkuar dokumentacionin e mjetit dhe pasi i paraqiti dokumentacionin Edison i komunikoi se do merrte masë administrative për shkeljen që kishte. Gjatë kohës që po plotësonte procesverbalin, drejtuesi i mjetit i tha që mos e shkruaj gjobën se e rregullojme ndryshe. Punonjësi i policisë i tha që nuk kanë si ta rregullojme ndryshe, por do marrësh gjoben dhe pastaj do largohesh. Në momentin që po printonte masën, drejtuesi i mjetit nxorri dorën nga xhami dhe i futi në dorën ku mbante tabletin dy kartëmonedha të prerjes 500 lekëshe, duke i thënë që pi një kafe dhe mos e vendos gjobën. Në këtë moment kanë njoftuar eprorin dhe sallën operative. Më pas i kane komunikuar që për këtë veprim do të shoqërohej në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë sepse e paralajmëroi një herë që nuk duhet ta kyente dhe se veprimi i tij përbën vepër penale. Më pas u bë shoqërimi i drejtuesit të mjetit në ambjentet e drejtorisë. Drejtuesi i mjetit ishte shtetasi Saimir Sulaj. Nga ana punonjesve te policise eshte vene masa administrative per shkeljen e nenit 170/8 për drejtim mjeti pa vendosur rripin e sigurimit.

I pyetur ne cilesine e personit qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, shtetasi Erjon Hoxha pohon theniet e kolegut te tij Edison Bajraktari.

Nga ana e policise gjyqesore u sekustrua ne cilesine e proves materiale (dy kartmonedha te preijes 500 (peseqind) leke te reja me numer serie KY979396 dhe KD884288.

Ne deklarimet e tij, shtetasi Saimir Ahmet Sulaj, sqaroi se nuk ka pasur si qellim korrupsionin e punonjesit te policisö, por eshte ngaterruar pasi ka edhe probleme me tensionin. Sqaron se ka gene i shtruar per 3 muaj per arsye shendetesore. Eshte penduar per veprimin, por nuk ka pasur qellim korrupsionin.

Ne perfundim te hetimeve prokurori ka konkluduar se i pandehuri Saimir Sulaj, ka konsumuar ne kete menyre elementet e figures se vepres penale te "Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike", parashikuar nga neni 244 pg.1 i K.Penal.

Ekzistenca e faktit penale bazohet ne: Informacion per referimin e vepres penale; Proces verbal i kapjes në flagrancë i datës 11.07.2021; Raport shërbimi i datës 11.07.2021; Procesverbal i kallëzimit penal të shtetasit Edison Bajraktari datë 11.07.2021; Procesverbal i deklarimit të shtetasit Edison Bajraktari datë 11.07.2021; Procesverbal i deklarimit të shtetasit Erjon Hoxha datë 11.07.2021; Procesverbal i kqyrjes dhe marrjes së dokumentave datë 11.07.2021; Procesverbal i sekuestrimit kartëmonedhave; Procesverbal i drejtave te arrestuarit datë 11.07.2021; Procesverbal arrest në flagrancë i shtetasit Saimir Sulaj datë 11.07.2021; Procesverbal i kontrollit të shtetasit Saimir Sulaj datë 11.07.2021; Procesverbal i deklarimit ndaj të cilit zhvillohen hetimet datë 11.07.2021.

Ne gjykim avokatja ishte dakort me burimet e provave te paraqitura nga prokurori. I pandehuri shprehu qendrim pohues dhe pendues per veprimet e kundraligjshme te kryera. I pandehuri dhe avokatja mbrojtese i kerkuan Gjykates te procedohet me gjykim te shkurtuar.

Ne konkluzionet perfundimtare avokatja mbrojtese kerkoi nje denim sa me te bute per te pandehurin, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim, dhe aplikimin e nenit 59 te Kodit Penal.

Vlersimi i gjykates.

Gjykata, e bazuar ne nenet 331, 332/dh pg. 1 germa "c", 405 të K.Pr.Penale, per kete çeshtje çmon se, nuk jemi perpara rasteve te pavlefshmerise se kerkeses se prokurorisë per dergimin e çeshtjes ne gjyq, te percaktuara ne nenin 331/2 te K.Pr.Penale. Nuk u konstatuan; akte te pavlefshme, prova te paperdorshme, nevoja per marrjen e provave te tjera. Veprimet hetimore te prokurorit jane kryer konform procedurave ligjore.

Meqenese çeshtja zgjidhjet ne gjendjen qe jane aktet dhe per shkak se nuk egziston rasti ndalues i percaktuar ne nenin 403/2 te K.Pr.Penale dhe ndonje nga rastet e percaktuara ne paragrafin 7 te ketij neni per mospranimin e gjykimit te shkurtuar, Gjykata ka vendosur pranimin e kerkeses te te pandehurit per zhvillimin e gjykimit të shkurtuar.

Ne nenin 244 te K.Penal me titull "Korrupsion aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike", nder te tjera eshte parashikuar se:

"-Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.

-Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet."

Në këto kushte, bazuar ne aktet e fashikullit hetimor te shendrruara ne dosje gjyqesore per shkak te zhvillimit te gjykimit te shkurtuar, Gjykata krijon bindjen tej çdo dyshimi te arsyeshem se i pandehuri Saimir Sulaj me veprimet e kundraligjshme te kryera, ka konsumuar plotësisht

elementët e figures te vepres penale per te cilen akuzohet, “Korrupsion aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike” parashikuar perkatesisht nga neni 244 pg. 1 i K.Penal.

- Objekt i kesaj vepre penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve të Policisë së Shtetit gjate ushtrimit te detyres, për të mos u ndikuar në kryerjen e detyrave dhe funksioneve publike nga veprimet korruptive, marrëdhënie keto të mbrojtura me legjislacionin penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.
- Nga ana objektive, vepra penale eshte kryer nga i pandehuri nepermjet veprimeve aktive te kundraligjshme, ne momentin qe po printonte masën e gjobes, drejtuesi i mjetit i ka dhene punonjesit te policise dy kartëmonedha të prerjes 500 lekëshe, duke i thënë që pi një kafe dhe mos e vendos gjobën.
- I pandehuri eshte subjekt i vepres penale sepse, ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem perpara ligjit per veprimet e kundraligjshme te kryera.
- Nga ana subjektive vepra penale eshte kryer me dashje direkte, me qellim perfitimi.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, Gjykata ka parasysh:

Rrezikshmërinë relativisht të larte shoqërore të veprës penale.

Rrezikshmërinë e pakët shoqërore të të pandehurit për të cilin rezulton se:

- i eshte caktuar mase “detyrim per paraqitje”,
- është i padënuar,
- ka shprehur pendim të thellë për veprën e kryer, fakt ky i parashikuar si rrethanë lehtësuese në nenin 48/ç të Kodit Penal.

Nisur nga rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe e të pandehurit, shkalla e fajit, Gjykata çmon se ai duhet dënuar me 9(nente) muaj burgim. Mbi këtë masë dënimi duhen zbatuar kërkesat e nenit 406.1 të K.Pr.Penale, duke i ulur të pandehurit 1/3 e dënimit, për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, i cili dënohet me 6(gjashte) muaj burgim.

Per sa i përket kerkeses se prokurorit per pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim per te pandehurin.

Gjykata i referohet nenit 59 të Kodit Penal, me titull "Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë" në të cilin ndër të tjera është parashikuar se:

- *"Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetsore,... dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin... si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, Gjykata kur jep një dënim me burgim deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit... "*

Duke analizuar dispozitën e mësipërme, Gjykata çmon se i pandehuri Saimir Sulaj i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, sepse:

- ka një rrezikshmëri të pakët shoqërore,
- i është caktuar një masë dënimi me burgim nën pesë vjet.

Nga sa u arsyetua më sipër, Gjykata çmon se duhet pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Saimir Sulaj.

I dënuari Saimir Sulaj duhet të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë dhe të vihet në provë për një afat 1(nje) vjeçar me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

Në zbatim të nenit 60/9 të Kodit Penal , duhet të detyrohet i pandehuri Saimir Sulaj që të mos shoqërohet me persona të dëmtuar ose me precedentë penalë.

Meqënëse i pandehuri rezultoi fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, në bazë të neneve 485 dhe 393 të K.Pr.Penale, ai duhet të ngarkohet me pagimin e shpenzimeve procedurale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në zbatim dhe të neneve 379 - 384, 390 të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

- Deklarimin fajtor te pandehurit **Saimir Ahmet Sulaj** per kryerjen e vepres penale “Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike”, bazuar ne nenin 244 pg. 1 te Kodit Penal, denimin e tij me 9 (nente) muaj burgim.
- Ne zbatim te nenit 406/1 te K.Pr.Penale, te pandehurit **Saimir Ahmet Sulaj** i ulet 1/3 e denimit dhe denohet me 6 (gjashte) muaj burgim.
- Bazuar ne nenin 59 te K.Penal, te pezullohet ekzekutimi i vendimit te denimit me burgim per te pandehurin **Saimir Ahmet Sulaj**.
- Urdherohet i denuari **Saimir Ahmet Sulaj**,te mbaje kontakte me Zyren Vendore te Sherbimit te Proves Tirane dhe te vihet ne prove per nje afat 1 (nje) vjeçar, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale. Afati i proves fillon nga e nesermja e shpalljes se ketij vendimi.
- Ne zbatim te nenit 60/9 te Kodit Penal, detyrimin e te denuarit **Saimir Ahmet Sulaj** qe te mos shoqerohet me persona te denuar ose me precedente penale.
- Provat materiale te sekuestruara dhe te evidentuara ne “Procesverbalin per sekuestrim e sendeve” te dates 11.07.2021, dy kartemonedha te prerjes 500 leke te kalojne ne favor te shtetit.
- Shpenzimet procedurale i ngarkohen te pandehurit.
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditesh duke filluar nga e nesermja e njoftimit te ketij vendimi.
- U shpall sot ne daten 23.02.2022.

Sekretare
Besarda Allaraj

Gjyqtar
Altin Abdiu

Shpenzimet gjyqesore
Njoftime 2x150 lekë

Avokate kryesisht 5000 leke
Hetimet parparake 2000 leke